

Akt themelimi
i
Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

“UNIVERSITETI I MILLENIUMIT” TEFTA SHAHINI” SH.P.K

Sot me datë 03.06.2013, Prof. Dr. Ladi Shahini, shtetas shqiptar, i biri i Jorgos dhe i Bukuries, i datelindjes 01.10.1947, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, rruga“ S.Pasha”, Pallati 124, Shkalla 3, Apart.32, me numer Karte ID 024398822, vendosi të themelojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “Universiteti I Milleniumit ”Tefta Shahini”, SH.P.K ,në të cilën i mësipërmi është ortak dhe për këtë qëllim harton këtë Akt Themelimi me përmbajtje si vijon :

Neni 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet “.Universiteti i Milleniumit “Tefta Shahini” SH.P.K dhe me poshtë do të quhet “Shoqëria”

Neni 2

Forma

2.1 Kjo Shoqëri është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

Neni 3

Baza Juridike

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit Nr.9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në QKR.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në rruga “S. Pasha”, Pall.124, Shk.3, Apart.32. Shoqëria mund të ndryshojë Selinë me vendim të ortakut.



4.2 Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëri Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose Shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj, në të gjithë territorin e Shqipërisë ose dhe jashtë saj.

Neni 5

Territori

- 5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 5.2 Shoqëria mund të krijojë degë (filiale), ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe në Shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

Neni 6

Objekti

6.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është kryerja e këtyre veprimeve tregtare:

Qëllimi i UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " është të promovojë dhe zhvillojë edukimin postsekondar, atë universitar dhe pasuniversitar në programet e përcaktuar prej tij, të lehtësojë kërkimin shkencor dhe divulgimin e rezultateve të tij, duke ruajtur njëkohësisht profilin e një entiteti juridik jofitimprurës dhe cilësor. Ky qëllim do të arrihet me ndihmën e mjeteve të mëposhtme:

- Pjesëmarrje në fillimin, zhvillimin dhe promovimin e programeve mësimore dhe të bashkëpunimit me partnerët;
- Pjesëmarrje, në bashkëpunim me aktorët kryesorë të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor, në dialogun social, në përgatitjen e projektligjeve dhe akteve të tjera ligjore, në dhënien e kontributit për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor, si edhe të strategjive të lidhura me punësimin dhe mbrojtjen e punësimit, me arsimin profesional dhe orientimin e formimit në përputhje me trendet e zhvillimit të ekonomisë së tregut;
- Mbrojtje ligjore të të drejtave dhe interesave të tij;
- Komunikim mbi veprimtarinë e UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI ";
- Botimin, riprodhimin dhe publikimin e materialeve metodike, arsimore, shkencore për promovimin e rezultateve të zhvillimit shkencor dhe të arritjeve të vetë universitetit;
- Zhvillimin, zbatimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, për të zhvilluar potencialin arsimor e shkencor dhe me qëllim arritjen e objektivave të UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI ";
- Lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me personat juridikë dhe fizike, për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut;



-Blerjen e pasurive të luajshme dhe të paluajshme, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë dhe funksionimin e duhur të UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI ";

-Organizimin dhe / ose pjesëmarrjen në takime, konferenca, simpoziume, kongrese, forume, tryeza të rrumbullakëta, ekspozita, seanca komunikimi të specializuara me pjesëmarrje të një publiku vendas dhe të huaj, bashkëpunim aktiv me organizata të huaja të ngjashme;

-Kontribut për mbështetjen këshillëdhënëse dhe ndihmë në fushat prioritare të trajnimit për arsimin publik parauniversitar;

-Kryerjen e detyrave të tjera që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut;

UNIVERSITETI I MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " gjithashtu ka si qëllim të tij, analizimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kulturore, profesionale dhe morale të stafit të tij dhe të të gjithë atyre që marrin pjesë në promovimin e edukimit në këtë shkollë të lartë jopublike.

UNIVERSITETI I MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " mund të sigurojë që të respektohet ligji dhe etika profesionale gjatë veprimtarisë mësimore shkencore dhe kërkesat e konkurrencës së ndershme në funksion të zhvillimit të programeve, degëve apo fakulteteve të rinj.

UNIVERSITETI I MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " mund të ofrojë shërbime konsulence, ekspertize dhe asistencë ligjore për stafin e tij.

VEPRIMTARIA E UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI "

Kuadri Rregullator: Gjatë veprimtarisë së tij UNIVERSITETI I MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " i nënshtrohet dispozitave të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Të drejtat: Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e vet, UNIVERSITETI I MILLENIUMIT

" TEFTA SHAHINI " do të ketë të drejtat e mëposhtme:

Të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e Themeluesve dhe ortakëve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar;

Të zhvillojë në Shqipëri të gjitha veprimtaritë e parashikuara në këtë akt themelimi, në statut dhe veprimtari të tjera të autorizuara nga legjislacioni shqiptar;

Të përfaqësojë interesat e ortakëve para autoriteteve publike dhe organizatave të tjera, si dhe para çdo personi juridik apo fizik dhe të ndërmarrë çdo veprim ligjor dhe veprime të tjera të nevojshme për të arritur qëllimet e tij;



Të bashkëpunojë me organizmat shtetërore në Shqipëri dhe të marrë të gjithë informacionet, dokumentet dhe aktet e tjera zyrtare të dobishme për aktivitetin e tij;

Të lidhë me persona juridikë dhe fizike marrëveshje bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit arsimor, teknik, shkencor, ekonomik, financiar dhe tregtar, për kryerjen e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve për të arritur qëllimet dhe detyrat e përcaktuara në aktin e themelimit dhe statut;

Të hapë dhe të mbyllë llogaritë bankare të nevojshme për veprimtarinë e këtij të fundit, pranë bankave të licencuara në Shqipëri dhe jashtë vendit, dhe të kryejë transaksione bankare në përputhje me kushtet kontraktuale që ai i konsideron të përshtatshme;

Të disponojë aktivet e tij dhe t'i administrojë ato në atë mënyrë që të mundësohet zhvillimi i veprimtarisë së UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " dhe të përfitohen të gjitha burimet financiare dhe materiale, të tundshme dhe te patundshme;

Të pranojë donacione, subvencione dhe sende dhe t'i disponojë ato;

Të punësojë stafin e nevojshëm për veprimtarinë e UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI "

– ku mund të marrin pjesë qytetarë të Republikës së Shqipërisë dhe / ose vendeve të tjera - dhe të përcaktojë nivelin dhe kushtet e pagesës dhe kushtet kontraktuale, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;

Të ushtrojë plotësisht atributet të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin mbi organizatat e punëdhënësve, personat juridikë, Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, etj;

Të shpërndajë lirisht informacion në lidhje me aktivitetin e tij, të krijojë, sipas nevojës, nëndarje territoriale, të krijojë në përputhje me ligjin, filiale ose të marrë pjesë si themelues, në themelimin e organizimeve të tjera me kapital të përbashkët, në funksion të realizimit të qëllimeve statutore;

Të lidhet me universitete, qendra kërkimore –shkencore dhe organizata ndërkombëtare e të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme me to;

Të drejta të tjera të lejuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Detyrimet: Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me parashikimet e këtij akti themelimi, të statutit dhe të rregullores, UNIVERSITETI I MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI " ka detyrime si në vijim:

A handwritten signature in black ink, appearing to be the name 'Rahman', written in a cursive style. The signature is positioned at the bottom center of the page.

Të sigurojë zbatimin e vendimeve, dispozitave dhe udhëzimeve të Senatit Akademik dhe të Administratorit të Përgjithshëm;

Të veprojë në mirëbesim dhe në interes të ortakëve; t'i informojë plotësisht ata mbi veprimtarinë mësimore –shkencore e mbi rezultatet financiare dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në çdo vendim që ka efekte financiare.

Të paguajë taksat dhe tatimet e detyrueshme në favor të buxhetit të shtetit në përputhje me ligjin;

Të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, normat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me veprimtarinë e IAL-ve, si dhe rregullat e vendosura nga statuti i UNIVERSITETIT TE MILLENIUMIT " TEFTA SHAHINI "

Shoqëria mund të kryejë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër ndihmes dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e vet për një afat të pacaktuar.

Neni 8

Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqindmije leke). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku.

Neni 9

Kontributet

9.1 Kapitali themeltar përbëhet nga kontributet e ortakut të shoqërisë si vijon:, 100.000 leke, që përbejnë 100% të kapitalit themeltar.

Neni 10

Pjesët e kapitalit themeltar

10.1 Kapitali themeltar është i ndarë në 100 kuota, me vlerë nominale 1000 lekë secila.



Neni 11

Administrimi

11.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një Administrator. Administrator i Shoqërise është ortaku i vetëm Z Ladi Shahini, shtetas shqiptar, i biri i Jorgos dhe i Bukuries, i datelindjes 01.10.1947, me numer Karte ID 024398822, me adrese ne rruga "S.Pasha", Pallati 124, Shkalla 3, Apart.32, Tiranë. Kjo detyrë do të ushtrohet për një periudhë 5 vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 12

Dispozita të Fundit

12.1 Shoqëria do të rregullohet, përvec këtij akti themelues dhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku dhe si i tillë do të miratohet në QKR Tiranë, në ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

12.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 kopje, në gjuhën Shqipe, secila me fuqi të njëjtë ligjore.

Themeluesi

Prof.Dr.Ladi Shahini

